



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3115 prot.

Himarë, më 29.04 . 2026

VENDIM

Nr. 14, Datë 29.04.2026

PËR

“MIRATIMIN PËR VËNIEN NË DISPOZICION PËR ZHVILLIM NË KUADËR TË NËNPROJEKTVE “QËNDRA E SHËRBIMEVE PUBLIKE PALASË” DHE “COPËZAT”, TË PASURISË SË LLOJIT KULLOTË, ME NR. 29/84 ME SIPËRFAQE TOTALE 54391 M2 (KULLOTË), NË ZK 2863, HIMARË, NË PRONËSI TË BASHKISË HIMARË, NË FAVOR TË MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT, DUKE RUAJTUR TË PANDRYSHUAR PRONËSINË MBI PASURINË DHE PA KRYER TRANSFERIM TË SAJ”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i përitësuar), neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe neni 54; VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive” (i ndryshuar) pika 49 ; ligjit nr.9693/2007,“Për fondin kullor”; VKM-në nr. 592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”; në vijim të shkresës nr.3180/1prot., të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 28.04.2026, miratoi me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 2 (dy) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin për vënien në dispozicion për zhvillim në kuadër të nënprojekteve “Qendra e Shërbimeve Publike Palasë” dhe “Copëzat”, të pasurisë së llojit kullotë, me nr. 29/84 me sipërfaqe totale 54391 m² (kullotë), në zk 2863, Himarë, në pronësi të Bashkisë Himarë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.
2. Miratimin për vënien në dispozicion për zhvillim në kuadër të nënprojekteve “Qendra e Shërbimeve Publike Palasë” dhe “Copëzat”, të pasurisë së llojit kullotë, me nr. 29/84

me sipërfaqe totale 54391 m² (kullotë), në zk 2863 duke ruajtur të pandryshuar pronësinë mbi pasurinë dhe pa kryer transferim të saj.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

